



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIMIT

1. Drejtuar: Operatorit Ekonomik “2 N” Shpk

2. Adresa: Rruga “Demokracia”, Pallati nr.2, Kati i Parë, Lagja Paskuqan Fushë, Paskuqan, Tiranë

3. OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

4. OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

5. Tipi i Kontratës: Punime ndërtimi

6. Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”

7. Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF- 89845-06-12-2026

8. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i rrugës nga kryqëzimi i Unazës së Madhe me rrugën “Nexho Konomi” në drejtim të lumit Lana”.

9. Fondi limit: 85,381,874.28 (tetëdhjetë e pesë milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër pikë njëzet e tetë) lekë pa TVSH.

10. Burimi i financimit: të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me VKB-së nr.100 datë 18.12.2025, ”Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026, të miratuar nga Prefekti Qarkut Tiranë me shkresën nr.Prot 43563/1, datë 24.12.2025.

11. Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik.

12. Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 20.08.2026

13. Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 54 Datë 24 Gusht 2026.

14. KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “K.TURJA” shpk

NUIS K81314014A

Vlera: 47,706,068.75 (dyzet e shtatë milion e shtatëqind e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” shpk

NUIS J91915001P

Vlera: 48,787,283 (dyzet e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk

NUIS L78006801F

Vlera: **50,287,456.81** (pesëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH

4. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” shpk

NUIS 810802422

Vlera: **51,123,523** (pesëdhjetë e një milion e njëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH

5. Operatori Ekonomik “LLAZO” shpk

NUIS K24218401K

Vlera: **52,523,575** (pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

6. Operatori Ekonomik “ALBAVIA” shpk

NUIS J81527001Q

Vlera: **53,137,906** (pesëdhjetë e tre milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa TVSH

7. Operatori Ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk

NUIS K11507003S

Vlera: **53,633,676.52** (shtatëdhjetë e nëntë milion e njëzet e dy mijë pikë njëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH

8. Operatori Ekonomik “BE - IS” SH.P.K

NUIS K71412003A

Vlera: **55,287,467** (pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

9. Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” shpk

NUIS K12911201C

Vlera: **56,586,619.30** (pesëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH

10. Operatori Ekonomik “2 N” shpk

NUIS L31615017L

Vlera: **57,343,909** (pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

11. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk

NUIS J66926804L

Vlera: **57,564,054.75** (pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

12. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “KEVIN CONSTRUKSION” shpk & “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” shpk

NUIS K71401004W & J62904264O

Vlera: **58,872,111.67** (pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

13. Operatori Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk

NUIS L42215009L

Vlera: **60,999,351.52** (gjashtëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

14. Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” shpk

NUIS K81716011V

Vlera: **63,611,197** (gjashtëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

15. Operatori Ekonomik “MARVELS”S Construction Group SHPK

NUIS J77506312B

Vlera: **64,120,092** (gjashtëdhjetë e katër milion e njëqind e njëzet mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

16. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “EGI-K” & “NDREGJONI” shpk

NUIS K77424401L & K31329048I

Vlera: **65,359,730.68** (gjashtëdhjetë e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë pike gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

17. Operatori Ekonomik “CURRI” shpk

NUIS J67902718S

Vlera: **68,899,820.08** (gjashtëdhjetë e tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet pikë zero tetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “BE-IS”shpk

Operatori Ekonomik “BE-IS” shpk nuk ka dorezuar dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit brenda afateve të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe për rredhje skualifikohet.

2. Operatori ekonomik “K.TURJA”shpk

Operatori ekonomik “K.TURJA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.15 ku është kërkuar “*Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit*”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), rezulton operatori ekonomik “K. TURJA” shpk ka deklaruar License, nr.PN-0619-08-2015, Kodi III.1B, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, ndërsa subjekti mbështeteës “POENA” Shpk ka deklaruar License nr.LN-8396-10-2024, Kodi III.2B ku përshkrimi i veprimtarisë është “Transport i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme”, çka bie në kundërshtim me dokumentet standarde të tenderit ku është përcaktuar “*Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta)*”. Operatori ekonomik “K.TURJA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.13 ku është kërkuar “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, çertifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga*

laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike”, pasi për autorizimin e prodhuesit për materialet elektrike nuk ka paraqitur kontratë ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit. Gjithashtu skedat teknike dhe kataloget për materialet tuba janë dokumente në gjuhë të huaj, të papërkthyer në gjuhën shqipe, në kundërshtim me nenin 24, pika 2, paragrafi i dytë, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) ku përcaktohet “Në procedurat e prokurimit nën kufinj të lartë monetar, gjuha e përdorur është gjuha shqipe” si dhe dokumentet standard të tenderit “Njoftimi i kontratës, “Seksioni” 4, pika 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X.Operatori ekonomik “K.TURJA” shpk nuk përmbush pikën 2.3.16, të Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, ku është kërkuar : “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)” 1 (një) eskavator me zinxhirë. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se operatori ekonomik “K.TURJA” shpk nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit mjetin 1 (një) Eskavator me zinxhirë. Operatori ekonomik “K.TURJA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve” -2 (dy) Punonjës pllakashtrues...”, pasi është mbështetur në më shumë se 50% të Kapacitetit Teknik, tek subjekti mbështetës “POENA” Shpk, për 2 (dy) Punonjës Pllakashtrues, cka bie në kundërshtim me nenin 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), citohet se: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

3. Operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION”shpk

Operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve në kantier punonjësin me inicialet E.B, i cili rezulton të jetë i angazhuar në kontratën me objekt “Rikualifikimi urban i zonës mbrapa pallateve të vjetra në rr. E Balshajve” si dhe kontratën me objekt “Ndertimi unaza Mustafa Koc-Veski-Kocaj, Asfaltim i unazës që lidh 5-së fshatrat”, me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontrata të cilat i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.Operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, gërma g) ku kërkohej: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkthyer, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me autoritetin kontraktor, bashkia tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk ka deklaruar mjetet të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt “Ndërtimi unaza Mustafa Koc-Veski-Kocaj, Asfaltim i unazës që lidh 5-së fshatrat” me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratë e cila vazhdon efektet ligjore – teknike dhe financiare, për mjetet:

1. Asfaltoshtues, Zhdog.46755 dt.24.05.2018,
2. Autobitumatrice me targë AA426YC,
3. Autobot Uji me targë AA781ZP,
4. Eskavator me zinxhir, Zhdog.7584 dt.1.2.2021,
5. Kamion me targë AB025EN,

6. Rul me vibrim 0108/8697 Zhdoganim dt 08.08.2001
7. Rrul me vibrim 12174628 Zhdog.38726 dt.03.05.2018
8. Greider 4-11993A Zhdoganim dt 08.08.2001
9. Vibrator betoni at.nr. 16 date 10.01.2017
10. Saldarice Fat. Nr.369930348 date 19.08.2020,

Operatori ekonomik “ALMO Konstruktion” shpk ka deklaruar mjetet të cilat janë të angazhuara gjithashtu në kontratën me objekt *Rikualifikimi urban i zonës mbrapa pallateve të vjetra në rr. E Balshajve*” me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratë e cila vazhdon efektet ligjore – teknike dhe financiare, për mjetet:

1. Asfaltoshtruese Zhdog.34844 dt.04.09.2004,
2. Greider 4-11993A Zhdoganim dt 08.08.2001,
3. Eskavator me zinxhir, Zhdog.7584 dt.1.2.2021,
4. Autobitumatrice me targë AA426YC,
5. Gazogjen Fat.nr.291 dt.29.08.2020,
6. Kamioncine me targë AB419CG
7. Eskavator me zinxhir, Zhdog.7584 dt.1.2.2021

Operatori ekonomik “ALMO Konstruktion” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.11 ku është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes si më poshtë:..2 (dy) Punonjës automakinist ...*”, pasi është mbështetur në më shumë se 50% të Kapacitetit Teknik, tek subjekti mbështeteës “VASHTEMIA” Shpk. Nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “ALMO Konstruktion” shpk nuk ka deklaruar asnjë punonjës automakinist, që të përmbushë 50% të kërkesës së sipërcituar, cka bie në kundërshtim me nenin 90 pika 2 paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), citohet se: “*Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor*”.

4. Operatori Ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk

Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:*

- a) *Librezë pune;*
- b) *Kontratë pune e vlefshme;*
- c) *Diplomë.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve me kohë të plotë në kantier punonjës në inicialet E.D, i cili rezulton të jetë i angazhuar në kontratën me objekt: “*Rehabilitimi i Infrastruktura rrugore në Njësinë Administrative Vaqarr - Pezë – Ndroq*”, me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, gërma g) ku përcaktohet se: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8)...”* “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me autoritetin kontraktor, bashkia tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk ka deklaruar mjetet Kamion targë AA916SD, Kamionçinë targë AB261GI, Kamion me vinc me targë AB716DJ, rrul me vibrim kompresor fat. 01, dt. 07.01.2021, betoniere kantieri 0.5 m3 cope 3. fat. 158 dt. 08.12.2020 dhe gazogjen cope 2. fat. 158, dt.08.12.2020, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt *“Ndertimi i ambienteve për shoqatën humanitare të invalideve paraplegjik dhe tetraplegjik të shqiperise, në pronën 99, repartit ushtarak 5011 / 45, Surrel, të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.*

Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit mjetet - Kamion me targë AA916SD, - Kamion me targë AB239OR, - Rrul me vibrim kompresor Fat. 01, dt. 07.01.2021, - Kamionçinë me targë AB261GI, - Asfaltoshtruese Dogana R659 date 27.06.2023, - Betoniere kantieri. Fat. 158 dt. 08.12.2020 dhe Gazogjen cope2. Fat. 158, dt.08.12.2020, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara, në kontratën e lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, me objekt: *“Rehabilitimi i Infrastruktures rrugore në Njësinë Administrative Vaqarr - Pezë – Ndroq”*, së cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.13 ku është kërkuar *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike”*, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, certifikatat e konformitetit për materialet Tuba janë paraqitur në gjuhë të huaj, të papërkthyer në gjuhën shqipe, dokumentacioni i paraqitur për materialet elektrike është në gjuhë të huaj i papërkthyer në gjuhën shqipe, dokumentacioni për bojra është paraqitur në gjuhë të huaj i papërkthyer në gjuhën shqipe si dhe nuk disponon çertifikatë konformiteti CE dhe certifikatë cilësie, në kundërshtim me nenin 24, pika 2, paragrafi i dytë, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) ku përcaktohet *“Në procedurat e prokurimit nën kufinj të lartë monetar, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”* si dhe dokumentet standard të tenderit “Njoftimi i kontratës, ”Seksioni 4, pika 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X. Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqiperise” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike)”, si më poshtë: 1- Teknik Topograf. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezultoi se operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “Varaku E” Shpk për 1 (një) teknik topograf, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90 pika 2 paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.*

5. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” shpk.

Operatori ekonomik “RSM COMPANY” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.6, ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: -1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve ose Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raporte testimi laboratorike të leshuara nga laborator të akredituar për kryerjen e testimeve për materialet kryesore të ndërtimit (asfalt, beton), sipas kërkesave të projektit”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik është mbështetur për përmbushjen e kërkesës për për 1 (një) punonjës të certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve, te subjekti mbështetës “ED Konstruksion” Shpk, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar cka bie në kundërshtim me nenin 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), citohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.

6. Operatori Ekonomik “LLAZO” shpk

Operatori ekonomik “LLAZO” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve...2 (dy) Punonjës pllakashtrues...”* pasi nga verifikimi i dokumentacionit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “LLAZO” për plotësimin e kërkesës për 2 (dy) Punonjës pllakashtrues është mbështetur tek subjekti mbështetës “BESTA” Shpk, për 2 punonjës pllakashtrues, në më shumë se 50% të kapacitetit teknik, cka bie në kundërshtim me nenin 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), citohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.

7. Operatori Ekonomik “ALBAVIA” shpk

Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2 .3.10 ku është kërkuar *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk ka deklaruar të njëjtin punonjës iniciale H. GJ në rolin e punonjësit Inxhinierit Elektrik edhe në rolin e punonjësit Teknik Elektrik çka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.5 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, librezë punë, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht: - 1 (një) Inxhinier Elektrik”* si dhe pikën 2.3.10 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme , si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik”*.

8. Operatori Ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk

Operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2 .3.10 ku është kërkuar *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional*

(dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik; - 2 (dy) Punonjës Betonues”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezultojnë se operatori ekonomik është mbështetur të kapacitetet teknike të subjektit mbështetës “COLOMBO LTD” Shpk për 1 (një) Teknik Elektrik dhe 2 (dy) Punonjës Betonues, çka përbën më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar në mbështetje, në kundërshtim me nenin 90 pika 2, paragrafi i katërt, i VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), citohet se: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.15 ku është kërkuar se: “Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezultojnë se operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk ka paraqitur Licensën 3.II B me nr. LN-9084-02-2025, e cila është licensë e lëshuar për transport të mbetjeve jo të rrezikshme, çka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.15, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku është përcaktuar kërkesa për disponim të Licencës për “Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta”.

9. Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” shpk

Operatori ekonomik “Vëllezërit HYSA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.13 ku është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kërkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, çertifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, dokumentacioni i dorëzuar për skeda teknike dhe katalog, për materialet elektrike janë dokumente të paraqitura vetëm në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer në gjuhën shqipe, çka bie në kundërshtim me nenin 24, pika 2, paragrafi i dytë, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) ku përcaktohet “Në procedurat e prokurimit nën kufinj të lartë monetar, gjuha e përdorur është gjuha shqipe” si dhe dokumentet standard të tenderit “Njoftimi i kontratës,” Seksioni 4, pika 4.7 **Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X.**

Operatori ekonomik “Vëllezërit HYSA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë),Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: 1 (një) Teknik Topograf”, pasi nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezultojnë se nuk ka deklaruar asnjë punonjës në rolin e punonjësit Teknik Topograf.

10. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk

Operatori ekonomik “INERTI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të

deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;*
- b) Kontratë pune e vlefshme;*
- c) Diplomë.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “INERTI” shpk ka deklaruar si drejtues teknik (inxhinier) të punimeve në kantier punonjës në inicialet P.N, cili rezultoi se është me profesion inxhinier Gjeolog, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”, ku në nenin 8, pika 2, ku përcaktohet se: “... Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”Operatori ekonomik “ INERTI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10, germa b), ku është kërkuar “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesëmarrës si dhe subjektet mbështetes të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetes, duhet të deklarojnë për stafin e tyre të dhenat si më poshtë:

- Per punonjesin teknik ndertimi, teknik topograf, teknik elektrik duhet te deklarohet emer/mbiomer, profili i punes, numer dhe date kontrate individuale të punës, diploma perkatese e shkolles se mesme si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin.*
- Per punonjesit e tjere te stafit teknik duhet te deklarohet emer/mbiomer, profili i punes, numer dhe date kontrate individuale të punës, numer dhe titull i kualifikimit per diplomën / dëshminë përkatëse, si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin bazuar ne Ligjin 15/2017.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të deklaruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezultoi se operatori ekonomik per punonjesit Teknik Ndërtimi, Teknik Topograf dhe Teknik Elektrik nuk ka deklaruar të dhënat për numër dëshmie ose diplomë si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin, numër dhe datë kontrate pune, çka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.10, germa b), të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, në dokumentet standard të tenderit. Operatori ekonomik “ INERTI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.11, germa a), ku është kërkuar “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetes të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetes duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm emrin/mbiomer, profilin e punes numrin dhe datën e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj“. Nga verifikimi i dokumentacionit të deklaruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik per punonjesit automakinist, buldozerist dhe eskavatorist nuk ka deklaruar numër dhe datë kontrate pune, numrin e dëshmise profesionale si dhe afatin e vlefshmerise së saj.

11. Operatori Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk

Operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk ka deklaruar mjetet si: Autobot uji me targë AA635NE, Autovinç me targë AA963AP, të cilat rezultojnë mjete të angazhuara në kontratën me objekt: “Ndërtimi i Qendrës “TEN” me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, e cila është kontratë ende në zbatim dhe vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk ka deklaruar mjetet si Autobitumatrice me targë AA456KK, Grejder me targë A1MT87, Autobot uji me targë AA635NE, Asfalto-shtruese Kontratë nr.rep 3120, nr.kol 1356, datë 23.07.2024, Spërkatës boje për vijëzime në rrugë faturë nr.8 datë 20.08.2005, Kontratë nr.rep 3120, nr.kol 1356, datë 23.07.2024, të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: “Ndërtimi i ambjentëve të shërbimeve brenda zonës “TEDA”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

12. Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” shpk

Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.15 ku është kërkuar se: *“Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”.* Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk ka paraqitur Licensën 3.II B me nr. LN-9084-02-2025, e cila është licensë e lëshuar për transport të mbetjeve jo të rrezikshme, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.15, të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ku është përcaktuar kërkesa për disponim të Licencës për “Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta.

13. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “EGI-K” & “NDREGJONI” shpk

Operatori ekonomik “EGI-K & NDREGJONI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” ku është përcaktuar: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se asnjë nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik “EGI-K & NDREGJONI” shpk nuk ka paraqitur bilanci për vitet 2023, 2024 dhe 2025. Operatori ekonomik “EGI-K & NDREGJONI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.1 ku kërkohet: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se asnjë nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik “EGI-K & NDREGJONI” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për punë të ngjashme. Operatori ekonomik “EGI-K & NDREGJONI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14 ku kërkohet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se asnjë nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik “EGI-K & NDREGJONI” shpk nuk ka paraqitur certifikata ISO të kërkuara Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI/ISO 9001:2015, Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI/ISO 14001:2015, Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI/ISO 45001:2018, Çertifikatën e menaxhimit të energjisë SSH/DIN/EN/UNI/ISO 50001:2018, Çertifikatën e Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor SSH/DIN/EN/UNI/ISO 39001:2012.

14. Operatori Ekonomik “CURRI” shpk

Operatori ekonomik “CURRI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14 gërma d), ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë: Çertifikatën e menaxhimit të energjisë SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001:2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO ose ekuivalente...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” shpk ka deklaruar

çertifikatën ISO 500001:2018 me afat vlefshmërie deri me 20.06.2026, dokument i cili rezulton të jetë jashtë afatit të vlefshmërisë nga data e hapjes së ofertave, konkretisht data 30.06.2026, për pasojë nuk përmbush kërkesën e pikës 2.3.14 për disponimin e Çertifikatës së menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI 50001-2018.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, operatorin ekonomik “2 N” shpk me adresë: “Rruga “Demokracia” , Pallati nr.2, Kati i Parë, Lagja Paskuqan Fushë, Paskuqan, Tiranë”, me vlerë totale prej: **57,343,909 (pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e nëntë) lekë pa TVSH**, është identifikuar si Oferta e fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **58,872,111.67 (pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë), lekë pa TVSH** siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit.

PO ☐ JO ☒